



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN

Nr. _____ Prot

Poličan , me _____.____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shpenzime per blerje dhe vendeje kamerash ne hyrje te qytetit dhe ne objektet arsimore.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35125300-2 - Kamera sigurie, 38651000-3 - Kamera

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **1,666,666** (nje million e gjashtëqind e gjashtedhete e gjashte mije e gashtëqind e gjashtedhete e gjashte) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Polican, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55,pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në

nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore **brenda dates 31 mars te vitit pasardhes***".

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

a) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit minimalisht për periudhën e 3-muajve të fundit 10 (dhjetë) punonjës të profilizuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të pajisur me Certificate për Menaxhim Projektësh (PMP , Prince2 etj) ose ekuivalente, për të cilin O.E duhet të paraqesë certifikatën përkatëse dhe të figurojë në listpagesa për periudhën e kërkuar;

- 1 (nje) inxhinier elektrik/elektronik ose ekuivalent, per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar;
- 1 (nje) specialist TIK , per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar;
- Minimumi 5 (pesë) punonjës të siguruar si teknik instalues/montues të pajisjeve elektronike ose profesione ekuivalente te certifikuar nga kompania prodhuese e kamerave, kjo e vërtetuar me listpagesat e 3-muajve të fundit sipas kodit perkates te profesionit dhe certifikatave te trajnimit nga prodhuesi;

Për stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomat/ Vertetim diplomimi sipas ligjit/Certifikatat perkatese te kursit apo trajnimit
- Duhet te figurojne ne listepagesat e kompanise E-Sig per 3 muajt e fundit.
- Nje punonjes mund te zotëroj më shumë së 1 certifikim /trajnim..

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nga ana e AK është kërkuar nje numer punonjesish prej 10 personash, sepse kontrata eshte komplekse dhe kërkon instalimin e sistemeve të kamerave Brenda 1 periudhe 1 mujore në rrugët hyrëse të qytetit, shkollat , kopshtet e cerdhet.

Konkretisht janë kërkuar

- 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per Menaxhim Projektesh (PMP , Prince2 etj) ose ekuivalente i cili do të jetë përgjegjës për organizimin dhe ndarjen e punëve të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të kontratës brenda afatit. Ky person do të

jetë përgjegjës për mbajtjen e kontakteve me stafin e AK dhe ndjekjen e të gjithë procedurave të nevojshme.

- 1 (nje) inxhinier elektrik/elektronik ose ekuivalent. Ky kriter është i nevojshëm pasi inxhinieri elektronik/elektrik është personi që do të angazhohet drejtpërdrejtë në mbikqyrjen e proceseve të instalimit të kamerave të cilat janë pajisje elektronike/elektrike dhe gjithashtu do të asistojë AK në rast defektesh gjatë periudhës së garancisë.
- 1 (nje) specialist TIK , per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar- Ky kriter është i nevojshëm pasi Specialisti Tik do të jetë personi përgjegjës për integrimin e të gjithë sistemit në një platformë të vetme, transmetimin e të dhënave në sallën e monitorimit në Bashki.
- Minimumi 5 (pesë) punonjës të siguruar si teknik instalues/montues të pajisjeve elektronike ose profesione ekuivalente të certifikuar nga kompania prodhuese e kamerave- Referuar VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR , montuesit/teknikët do të jenë personat e drejtpërdrejtë që do të angazhohen në kryejren e punimeve për furnizim-vendosjen e kamerave në pikat e caktuara nga AK etj. Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjeve brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktet që do të montojnë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë Autorizim të prodhuesit/ve ose Distributorit të autorizuar prej prodhuesit për sistemet e kamerave (per zerat ne preventiv me numer 1, 2, 3, 4, 12, 13, 20, 21) .

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij kurse ne rastin e Autorizimit nga Distributori i Autorizuar do te paraqitet dhe akt-marveshja/akti perkates.

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6,8 të nenit 40, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike

2.3.4 Operatori ekonomik të paraqesë në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara katalogë / broshura / të prodhuesit për paisjet e kërkuara (per zerat ne preventiv me numer 1, 2, 3, 4, 12, 13, 20, 21) me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse paisjet e ofruara janë sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 6 , gërma c) dhe pikës 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit të sipërcituara ka për qëllim verifikimin e përputhueshmërisë së produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë të interesuar me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi me sukses.

2.3.5 Per shkak se kjo eshte nje procedure Furnizim-Vendosje malli dhe do te kete nevojë per kryerjen e puneve per instalimin e produkteve , Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me License Profesionale te leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise te kategorise :

NS 13 A- Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5, gërma a të VKM nr.285, datë19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo licence eshte e lidhur menatyren dhe llojin e procedures se prokurimit e cila eshte furnizim-vendosje.

Në pikën 18 të nenit 4 të LPP parashikohet se:

18. “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave.

Një kontratë publike furnizimi mund të përfshijë në mënyrë **dytësore edhe vendosjen edhe instalimin.**

Kërkesa për kategorinë NS bazohet në VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI” e ndryshuar ku parashikohet se:

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë :

a) Deklarate me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe konfigurimet përkatëse të pajisjeve në pikat e përcaktuara..

b) Deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e tyre në rast defektesh nga prodhuesi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter vendoset në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet pasi mallrat objekt prokurimi duhet të transportohen dhe montohen në të gjithë adresat e përcaktuara në plan shpërndarje.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Certifikate: ISO/IEC 20000-1 – Per teknologjine e Informacionit-Menaxhimi iShërbimit
- b. Certifikate: ISO 39001 - Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor ;

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të dispozojë certifikatat ISO sipas zërave/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

Argumentim: Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana e AK është kërkuar zotërimi i certifikatave:

Certifikate: ISO/IEC 20000-1 – Per teknologjine e Informacionit-Menaxhimi i Shërbimit ; ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre).

Certifikate: ISO 39001 - Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor ;- ISO 39001 tregon përmbushjen e standarteve më të mira në menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor dhe duke qenë se një pjesë e madhe e punimeve për instalimin e kamerave do të kryhet në rrugët dhe kryqëzimet kryesore në qytet, është një garanci për Ak se operatori ekonomik ka kaluar një proces vlerësimi sa i përket respektimit të këtyre standarteve nga organizma serioz.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë **2 (dy) automjete** për realizimin e instalimeve, për të cilët duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Lejen e qarkullimit
- Policen e sigurimit
- Certifikaten e kontrollit teknik
- Taksat vjetore

Ne rast se mjetet e lartpërmendura janë marre me qera ofertuesi duhet të paraqesë ***Kontratën e marrjes me qira të mjetit***, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre

Në lidhje më afatin e lëvrimit të mallit nga ana specialistit të fushës u vlerësua se nisur nga volumi i kontratës, proceset që do kryhen transport, furnizim vendosje, konfigurim, integrim i pajisjeve), afati i lëvrimit do të jetë 30 tridhjetë dite kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

Për operatorët ekonomikë:

Shënim: Mbështetur në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6 dhe 7, të këtij neni, ku parashikohet:

1. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë ngarkuar më vete në SPE .

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi i Artikullit	Njesia	Sasia
1	F.V NVR 16 KANALE INTELIGJENTE	COPE	1
2	F.V KAMERA E JASHTME IP 4 MP	COPE	8
3	F.V DVR 5 MPX 4 KANALE INTELIGJENTE	COPE	5
4	F.V KAMERA E JASHTME 5 MPX	COPE	20
5	F.V HDD 1TB	COPE	5
6	F.V HDD 4TB	COPE	1
7	F.V MBAJTESE METALIKE PER KAMERA	COPE	8
8	F.V KABELL RG59 USHQIMI	METER	1200
9	F.V KABELL RRJETI CAT6	METER	1000
10	F.V MIKROTIK	COPE	9
11	F.V FIBER OPTIKE 4 FIJE	METER	4000
12	F.V SWITCH 4 PORTA POE	COPE	3
13	F.V SWITCH 8 PORTA GIGABIT	COPE	6
14	F.V KUTI IP67 PER SHTYLLE	COPE	3
15	F.V SUPORT PER KAMERA	COPE	20
16	F.V MBAJTESE PER SHTYLLE	COPE	11
17	F.V KANALINA	METER	1500
18	F.V KABULL KORENTI	METER	400
19	F.V ZGJATUES KORENTI	COPE	10
20	F.V MONITOR 18"	COPE	5
21	F.V MONITOR 27" FHD	COPE	1
22	F.V PRIZE RACK PDU	COPE	1
23	F.V RACK	COPE	1

Afatet e lëvrimit: 30 dite kalendarike

NJESIA E PROKURIMIT